

## LIGJERATAT E DREJTA FAMILJARE DHE TRASHËGIMORE

### KUPTIMI I SË DREJTËS FAMILJARE

**28.02.2015**

E drejta familjare është pjesë përbërëse e sistemit juridik dhe njëkohësisht disiplinë e veçantë shkencore.

Ajo studion aspektet e rregullimit juridik të familjes, martesës, birësimit, të drejtave prindërore, kujdestarin.

Studion normat ligjore, i komenton, i shpjegon dhe i kritikon paqartësitë dhe mangësitë e tyre juridike.

Kohëve të fundit vërehet një ndikim më i madh i së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtën e brendshme të një vendi.

E drejta familjare historikisht ka qenë pjesë përbërëse e së drejtës civile.

Janë të njohura dy sisteme të së drejtës civile:

I Pandektisteve gjerman dhe sistemi Gajit.

Vetëm në shekullin XIX e drejta familjare është quajtur me emrin e saj të vërtetë e drejta familjare nga pandektistet gjerman.

E drejta familjare si disiplinë shkencore sot mësohet në të gjitha universitetet e botës.

Ligji për familjen i Kosovës të drejtën familjare e ka sistemuar në 8 pjesë.

Në fund të shekullit XIX janë miratuar KC Austriak të miratuar 1811, Gjerman 1896, Napelionit 1804, i Shqipërisë 1929.

### OBJEKTI I SË DREJTËS FAMILJARE

Objektin e së drejtës familjare e përbëjnë tërësia e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet të cilat lindin nga familja: martesa, birësimi, kujdestaria, marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, etj.

Objekti i së drejtës familjare përbëhet në radhë të parë nga marrëdhëniet e natyrës personale, por edhe nga marrëdhëniet pasurore që janë dytësore

Marrëdhëniet juridike familjare bazën e kanë në veprimet e njerëzve të parapara në ligj ose mos veprimet si dhe në ngjarje.

### PARIMET THEMELORE TË SË DREJTËS FAMILJARE

- a) **Parimi i barazisë në marrëdhëniet familjare:** të gjithë anëtarët e familjes janë të barabartë në pikëpamje të drejtave dhe detyrimeve pafarsisht nga statusi dhe seksi

**b) Parimi i shuarjes së ndikimit të organizatave fetare.**

Popullin shqiptar e karakterizon një heterogjenitet i besimeve fetare (muslimon, ortodoks dhe katolik) për secilin besim fetar kanë vlejtur rregulla të caktuara për lidhjen e martesës. **Martesën religjioze e rregullon edhe LFK-a.**

c) **Parimi i mbrojtjes shtetërore dhe shoqërore të familjes**, familja është e mbrojtur nga shteti dhe shoqëria. Ppjesa dërmuese e dispozitave të LFK-së janë të karakterit imperativ.

ç) **Parimi i lajcitetit** ndikimi i organizatave fetare në rregullimin e marrëdhënieve martesore familjare mënjanohet pas Luftës së Dytë Botërore, **Kushtetuta e RFPJ-së e vitit 1946** ka paraparë: mbrojtje shtetërore të familjes dhe martesës, rregullimin me ligj të marrëdhënieve familjare dhe martesore, barazinë e gruas me burrin në të gjitha sferat e marrëdhënieve familjare dhe martesore dhe formën civile të lidhjes së martesës.

d) **Parimi i mbrojtjes së veçantë të fëmijëve fëmijët** janë të mbrojtur si me Ligjin e familjes së Kosovës edhe me Konventat ndërkombëtare. Fëmijët e lindur jashtë martese janë të barabartë me fëmijët e lindur në martesë.

## **BURIMET E SË DREJTËS FAMILJARE**

Ndahen në burime materiale dhe formale

**Burimet materiale shprehin fuqinë** e shoqërisë e cila e krijon dhe u jep përmbajtjen vet normave juridike

Me burime formale juridike kuptojmë formën në të cilin shprehet norma juridike.

Burimet formale juridike ndahen në dy grupe

- 1. Burimet e drejtpërdrejta si ligji, Kushtetuta, Rregulloret dhe aktet e tjera të shkruara normative**
- 2. Burimet e tërthorta, si zakoni në raste të veçanta, praktika gjyqësore në mënyrë subsitare dhe doktrina juridike.**

**Burimet e drejtë për drejta ndahen në burime themelore dhe burime plotësuese.**

**Burimet ndërkombëtare** të së drejtës familjare janë aktet e përgjithshme juridike ndërkombëtare si Karta e OKB-së, Rezolutat e OKB-së, Konventat Ndërkombëtare si ajo e Hagës për Birësimin, Konventat për mbrojtjen e fëmijëve 1958, 1989.

**Zakoni si burim i së drejtës familjare.** Normat zakonore janë rregullat e sjelljes në shoqëri, të cilat krijohen me një përsëritje të tyre të vazhdueshme në kohë dhe hapësirë, për një periudhë relativisht të gjatë. Zakonet prapanike dhe konservative nuk mund të jenë burim i së drejtës familjare.

**Ligji si burim i së drejtës**, LFK-ja, Ligji për barazi gjinore, Ligji për ndalimin e dhunës në familje, Kushtetuta si burim i së drejtës familjare praktika gjyqësore si burim i së drejtës familjare, shkenca juridike familjare si burim i së drejtës familjare.

**Mendimi teorik shkencor** dhe analizat e thella shkencore nuk e kanë forcën e detyrimit të obligueshëm si në të drejtën Romake (**communis opinio doctorum**)

**Metodat e së drejtës familjare**

- a) **Normative**
- b) **Sociologjike**

## **E DREJTA TRASHËGIMORE**

**Lindja e së drejtës trashëgimore.** Si kategori shoqërore trashëgimia ka lindur në bashkësi primitive shoqërore, kur sendet u përkasin personave vetëm si posedim dhe rregullohej me norma të së drejtës zakonore si disiplinë shkencore e drejta trashëgimore ka lindur pas lindjes së shtetit dhe së drejtës.

**Objekti i së drejtës trashëgimore përbëhet nga sendet e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të drejtat reale të lidhura me pasuri.** Përbërja e objektit të së drejtës trashëgimore konsiston në të drejta reale, në të drejta të detyrimeve dhe në pronësi intelektuale.

**Zhvillimi historik i së drejtës trashëgimore.** Dallojmë katër periudha të zhvillimit historik të së drejtës trashëgimore.

**Periudha e parë përfshinë prridhen 1945-1955. Periudha e dytë 1955-1972, periudha e tretë 1972-1975 dhe periudha e katërt 1975-2004.**

**Veçimi i sendeve nga pasuria trashëgimore.** Nga pasuria trashëgimore veçohet prona e përbashkët e bashkëshorteve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, orenditë shtëpiake të vlerës së vogël, shtroja, mbuloja dhe sendet e tjera që shërbejnë për plotësimin e nevojave të përbashkëta të anëtarëve të familjes.

**Caktimi i vlerës së pasurisë trashëgimore.** Pasuria trashëgimore përbëhet nga aktiva dhe pasiva. **Vlera llogaritare e pasurisë trashëgimore përbëhet nga totali i vlerës neto të pasurisë trashëgimore dhe i vlerës së dhuratave të cilat trashëgimlënësi i ka dhuruar gjatë jetës së tij.**

**Parimi i barazisë së trashëgimtarit**

**Parimi i trashëgimisë testamentare**

**Parimi i kufizimit të bazave juridike të trashëgimisë**

**Parimi i suksesorit universal**

Parimi i suksesorit singular

Parimi ipso jure i trashëgimisë

Parimi i zbatimit paralel të bazave të trashëgimisë

## **Ligjerata 13. 03. 2015**

**Trellojshmëria e lidhjes familjare**

**Gazat themelore për lidhjen e martesës si në të kaluarën edhe tani janë:**

- a) Gjinia
- b) Martesa
- c) Bashkësia jomartesore

**Gjinia është lidhje në mes të dy apo më shumë personave, e themeluar me lindje (mënyra natyrore) apo me anë të ligjit. Gjinia duhet të jetë e njohur nga ligji dhe zakoni.**

**Në promiskuitet, gjinia ishte e pa rregulluar me ligj, një grup i tërë burrash të një fisi ishin të martuar me një grup të tërë grash po të atij fisi.**

**Ligji për familjen njih tre lloje të gjinisë:**

- A) Gjinin e gjakut
- B) Gjinin e krushqisë
- C) Gjinin e birësimit.
- D) E drejta kanonike njih gjininë e kumbarisë, kurse e drejta e shariatit të qumështit.
  - A) Gjinia e gjakut është lidhje prej gjakut, që krijohet mes dy ose më shumë personave që rrjedhin njëri prej tjetrit, ose prej një të paralinduri të përbashkët.

**Duke rrjedh njëri prej tjetrit krijohen shkallët vijat, që shërbejnë për matjen e afërsisë gjini.**

**Në gjininë e gjakut na formohen dy lloj vijash: e drejtë dhe e tërthortë. Vija e drejtë mund të jetë hipëse dhe zbritëse.**

**Vija e tërthortë mund të jetë jo e plotë, kur të afërmit gjini e kanë të përbashkët vetëm njërin prindër, dhe e plotë, kur të afërmit gjini kanë të përbashkët të dy prindërit.**

**Gjinia e gjakut llogaritet në atë mënyrë që çdo lindje formon një shkallë, sa lindje ka aq ka edhe shkallë.**

Kur është fjala për llogaritjen e gjinisë së gjakut në vijë të tërthortë na formohet trunçu, të cilën e përbëjnë dy prindërit ose bashkëshortët

Nuk ka shkallë të parë kur llogaritet gjinia e gjakut në vijë të tërthortë dhe numërimi fillon gjithmonë nga shkalla e dytë.

Rëndësia e gjinisë së gjakut. Ajo është pengesë absolute martesore në shkallë vija të parapara me ligj. Në vijë të drejtë pakufi kurse në vijë të tërthortë deri në vijën e katërt.

Gjykatësi, prokurori i shtetit, noteri nuk mund ta ushtrojnë funksionin e tyre nëse me palë procedurale janë persona gjini gjaku në vijë të drejtë pa kufinjë, në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt.

Në të drejtën trashëgimore gjinia e gjakut është fakt për caktimin e radhëve ligjore të trashëgimisë.

## **B) GJINIA E KRUSHQISË**

Gjinia e krushqisë është lidhje që krijohet midis njërit bashkëshort me të afërt gjini gjaku të bashkëshortit tjetër. Bazë e vetme për krijimin e gjinisë së krushqisë është martesa.

Gjinia e krushqisë është e përhershme.

Bazë e krijimit të gjinisë së krushqisë nuk mund të jetë bashkësia jomartesore.

Llogaritja e gjinisë së krushqisë është e njëjtë sikurse llogaritja e afërsisë dhe largësisë të gjinia e gjakut.

Gjinia krushqisë është pengesë martesore deri në shkallë të dytë, por është e evitueshme sepse, për shkaqe të arsyeshme, gjykata mund ta lejon lidhjen e martesë në mes të dhëndrit dhe vjehrrës, ose nuses dhe vjehrrit.

Gjykatësi, prokurori i shtetit, noteri nuk mund ta ushtrojnë funksionin e tyre nëse me palë procedurale janë persona gjini krushqie në vijë të drejtë pa kufinjë, ndërsa në vijë të tërthortë deri në shkallën e dytë.

### **C) Gjinia e birësimigt**

Gjinia e birësit krijohet me akt juridik mes të birësuarit dhe birësuesit, jo melindje.

Llgaritja e gjinisë së birësimit është e njëjtë si te gjinia e gjakut.

Birësimi është pengesë absolute martesore e pa evitueshme.

## **E drejta trashëgimore**

**T**rashëgimi çelët (dellatio) në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Të drejtat e vjetra kanë përcaktuar rregullën (*viveris non datur heredita*), i gjalli nuk trashëgohet.

Në momentin e çeljes së trashëgimisë trashëgimtarë e thirrur në trashëgimi fitojnë të drejtën e trashëgimit. Në trashëgimtarë kalojnë vetëm ato të drejta dhe detyrime që trashëgimlënësi kishte në momentin e vdekjes së tij.

Shpallja e personit të zhdukur si i vdekur barazohet me vdekjen faktike. Vdekja faktike vërtetohet me aktvdekje të lëshuar nga ofiqari, ndërsa vdekja e personit të shpallur si i vdekur me aktvendim të gjykatës.

Në kohen e çeljes së trashëgimisë përcaktohet edhe rrethi i trashëgimtarëve ligjor dhe me testament.

Lidhet juridikisht momenti i parashkrimit të kërkesës për zvogëlimin e disponimeve me testament.

Lidhet edhe fakti i parashkrimit të kërkesës për trashëgimi i përcaktuar me dispozita të LTK-së.

# Vendi i çeljes së trashëgimisë

Aty ku trashëgimlënësi kishte vendbanimin dhe vendqëndrimin e tij. Nëse vendqëndrimi dhe vendbanimi nuk dihej, atëherë ku e kishte vendqëndrimin dhe vendbanimin e fundit në Kosovë ose ku ndodhej pasuria e tij ose pjesa më e madhe e pasurisë së tij.

## 1. Trashëgimlënësi

Trashëgimlënës mund të jetë çdo person fizik që pas vetës të ketë lënë pasuri trashëgimore.

Nëse testamentlënësi e ka disponuar pasurinë e tij me testament *inter vivos*, që testamenti të jetë i plotfuqishëm duhet të plotësohen në mënyrë komulative dy kushte themelore: *të ketë mbushur 18 vjet ose mbi 16 vjet por të jetë i martuar si dhe të ketë zotësinë e veprimit.*

## 2. Trashëgimtar

Mund të jetë personi fizikë që ka qenë i gjallë në momentin e çeljes së trashëgimisë ose të ketë lindur brenda afatit prej 300 ditësh nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit. Personat juridik mund të trashëgojnë vetëm me testament.

## 3. Zotësia për të trashëguar

Zotësinë për të trashëguar e ka trashëgimtari që ka përjetuar çastin e deflacionit ose ka lindur brenda afatit prej 300 ditësh.

## 4. Bazat për thirrje në trashëgimi

- a) *Trashëgimi me ligj*
- b) *Trashëgimi me testament*

Sistemet për caktimin e radhëve për thirrje në trashëgimi ligjore

- a) **Sistemi i gjakut të përbashkët**
- b) **Sistemi i shkallëve të gjinisë**
- c) **Sistemi parentelar**

a) Sistemi i gjakut të përbashkët. Bazë për caktimin e radhëve të trashëgimisë ligjore sipas këtij sistemi është sasia e gjakut të përbashkët të personave gjini me trashëgimlënësin.

Fëmijët trashëgojnë **50 %** të faktorëve të gjakut prej secilit prind, **25.5** prej gjyshërive, **12.5** nga stërgjyshit.

**Në radhën e parë** të trashëgimisë sipas këtij sistemi trashëgojnë vëllazëritë dhe motrat që rrjedhin prej prindërve të përbashkët që supozohet se kanë 100 % gjakun e përbashkët

Në **radhën e dytë** prindërit dhe vëllazëritë dhe motrat që rrjedhin vetëm nga njëri prind i përbashkët, që kanë 50 % të gjakut të përbashkët.

### **Sistemi i shkallëve të gjinisë**

Sipas këtij sistemi në radhë të parë trashëgojnë:

- 1) Fëmijët e prindërit e trashëgimlënësit;**
- 2) Nipërit e mbesat dhe gjyshet dhe gjyshërit e trashëgimlënësit**
- 3) Stërnipërit dhe stërmbesat e stërgjyshit dhe stërgjyshet e trashëgimlënësit**

### **c) Sistemi parentelar**

Sipas këtij sistemi personat gjini grupohen në parentela, prej nga edhe sistemi merr emrin. Parentela (brez) quhet grupi i personave gjini që kanë prejardhje prej një personi të përbashkët. Në bazë të afërsisë së personave gjini janë formuar parentela: e para, e dyta, e treta dhe kështu me radhë.

**Parentelen e parë e përbëjnë të gjithë personat gjini** që rrjedhin nga trashëgimlënësi si plak i tyre i gjinisë. Ata janë fëmijët e tij dhe pasardhësit e tij.

**Në të dytën hyjnë prindërit e trashëgimlënësit**, me pasardhësit e tyre. Ata janë vëllazëritë dhe motrat e trashëgimlënësit.

**Në parentelen e tretë bëjnë pjesë gjyshërit dhe gjyshet** me pasardhësit e tyre

Në parentelen e katërt bëjnë pjesë stërgjyshit dhe stërgjyshet me pasardhësit e tyre

### **Sistemi parentelar ka dy nënsisteme:**

#### **Nësishtimin parentelar gradual**

Bazë për formimin e radhëve ligjore të trashëgimisë nga personat në gjini është shkalla (gradus). Kjo bënë që në trashëgimi të thirren vetëm personat më të afërt gjini me trashëgimlënësin. Trashëgimtarët e të njëjtës shkallë trashëgojnë në mënyrë të barabartë.

#### **Sistemi parentelar linar.**

Pa kufizim zbatohet e drejta e përfaqësimit (jus representationes). Nëse një trashëgimtar i një vije ka vdekur para trashëgimlënësit dhe ka lanë pasardhës, pasardhësi do të trashëgojë me zëvendësim në vend të trashëgimtarit të vdekur para trashëgimlënësit. Ai do të trashëgonte atë që do ta kishte trashëguar trashëgimtarin, sikur të ishte gjallë.



**Më 20.03. 2015**

## **KUPTIMI I SË DREJTËS MARTESORE**

E drejta martesore është e drejtë pozitive. Pjesa më e madhe e normave juridike, me të cilat rregullohet e drejta martesore janë të natyrës operative , si lidhja dhe zgjidhja e martesës, ndërsa vetën një pjesë e vogël janë të natyrës dispozitive, si caktimi i mbiemrit me rastin e lidhjes së martesës, vendbanimi.

E drejta martesore është edhe pjesë përbërëse e shkencës familjare juridike.

**Objektin e së drejtës martesore** e përbëjnë martesat dhe marrëdhëniet martesore. Marrëdhëniet martesore janë të natyrës personale, që krijohen me rastin e lidhjes së martesës dhe pasurore juridike

**Subjekt të së drejtës martesore** janë bashkëshortët, por gjithnjë e më shumë edhe bashkëshortët jashtëmartesor.

Parimet e së drejtës martesore janë të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

**Parimi i barazisë.** Bashkëshortët janë të barabartë, si gjatë lidhjes së martesës, gjatë martesës dhe me rastin e zgjidhjes së martesës. LFK e përkufizon martesën si bashkësisë ligjore të burrit dhe gruas të bazuar në barazi juridike dhe morale.

**Parimi i laicitetit** . Martesa është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas e bazuar në ligj. Më 1929 për herë të parë në Shqipëri është futur martesat civile. Ka vazhduar edhe pas Luftës së Dytë Botërore dhe vazhdon edhe sot.

**Parimi institucional.** Martesa është institucion shoqëror juridik dhe gëzon mbrojtje shoqërore. Martesa është te ne një institucion laik dhe gjen mbrojtje vetëm martesat civile.

**Parimi i monogamisë.** Me monogami kuptojmë martesën në të njëjtën kohë e një burri dhe një ruaje. Është shprehje e civilizimit dhe qytetërimit të njerëzimit. Nuk do të thotë se një njeri vetëm njëherë ka qenë i martuar gjatë jetës së tij.

**Parimi i vazhdimësisë** së jetës martesore. Martesa lidhet pa kushte dhe pa afat të kufizuar, por zgjatë aq sa zgjatë edhe jeta e bashkëshortëve.

Martesa si institucion juridik dhe shoqëror. Edhe në doktrinë juridike , edhe në rregullativë ligjore ka pasur dilema rreth konceptit të natyrës juridike të martesës. Në të drejtën romake është trajtuar si kontratë, specifike sepse rregullohet me norma ligjore imperative. Disa dietar si Emanuel Levi, Bankas e të tjerë martesën e kanë quajtur institucion juridik dhe shoqëron sepse me lidhjen e martesës nuk arrihet asgjë e re

vetëm ndërron statusi i bashkëshortëve, prej beqar bëhet i martuar dhe formohet familja.

Për lidhjen e martesës duhet të shprehin vullnetin dy persona të gjinive të kundërta, ekzistojnë pengesat martesore, ndërsa për lidhjen e kontratës nuk është e domosdoshme gjina e kundërt e palëve kontraktuese dhe nuk ka pengesa martesore.

**Madestin** jurist romak para shek. IV të erës sonë martesën e përkufizon si lidhje të një burri dhe të një gruaje për gjithë jetën dhe një bashkësi e së drejtës hyjnore dhe njerëzore.

*Ne mendojmë se martesë është bashkësi jetësore e një burri dhe një gruaje, që lidhet para organit kompetent me shprehjen e pëlqimit të lirë sipas procedurës së paraparë ligjore, një akt solemn i mbështetur në barazinë morale dhe juridike, në ndenjë të dashurisë, të respektit, të mirëkuptimit të ndërsjellët.*

**Qëllimi natyror** i martesës është lindja dhe mirërritja e fëmijëve si dhe kryerja e marrëdhënieve seksuale.

**Qëllimi moral** është këshillimi dhe përkrahja morale bashkëshortit në fatkeqësi, me këshilla dhe forma të tjera.

**Qëllimi shoqëror** është se martesë nuk është çështje private, veçse institucion shoqëror dhe juridik, një celulë e familjes që ka për qëllim lindjen dhe rritjen e fëmijëve. Është një institucion juridik i rregulluar kryesisht me dispozita imperative ligjore.

**Kushte për lidhjen e martesës janë:** kushtet materiale ose thelbësore, kushtet për vlefshmërinë e martesës të përkufizuara negativisht, që paraqiten si pengesa martesore, dhe kushtet që ndalojnë lidhjen e martesës dhe paraqiten si ndalesa martesore.

**Vullneti i shprehur** lirisht është kusht themelor për lidhjen e martesës. Mund të shprehet me gojë dhe me shkrim. Ky shprehet me gojë duhet deklarata të futet në procesverbal. Vullneti shprehet përnjëherë nga dy bashkëshortët, suksesivisht njëherë njëri dhe njëherë tjetri. duhet të jetë afirmativ, serioz, real.

**Sekset e kundërta** përbëjnë komponentët civilizuese, biologjike dhe kulturore të martesës. Nuk mund të lidhin martesë personat me sekse të njëjta.

**Martesa me persona biseksual**, është e pavlefshme nëse organi dominues i personit, i bashkëshortit biseksual është i njëjtë me organin seksual të bashkëshortit tjetër.

**Ndryshimi i seksit** është pengesë për lidhjen e martesës, sepse vetëm improvizohet organi seksual e në realitet mbetet organi gjenetik seksual që e kishte edhe para operacionit. Kromozomet nuk ndryshojnë, dhe martesat janë sterile

**Martesa lidhet para organit të ofiqarisë**, në prezencën e dy bashkëshortëve dhe dy dëshmitarëve. Martesa konsiderohet e lidhur në momentin kur bashkëshortët deklarohen në mënyrë afirmative për lidhjen e martesës.

## **E DREJTA MARTESORE**

Radha e parë e trashëgimisë ligjore për bëhet nga pasardhësit e trashëgimlënësit, i birësuari dhe bashkëshorti.

Trashëgojnë si bashkëshorti martesor edhe ai jomartesor nëse plotësohen këto kushte. Të kenë jetuar 10 vjet në martesë, pa fëmijë të përbashkët, 5 vjet në martesë me fëmijë të përbashkët dhe të mos jenë në martesë civile trashëgojnë si fëmijët e përbashkët legjitim dhe fëmijët e përbashkët ilegjitim. Të gjithë trashëgimtarët trashëgojnë një pjesë të barabarta.

Me të drejtën e përfaqësimit kuptojmë kur pasardhësi paraqitet me zëvendësim në vend të paraardhësit, në kuadër të një vije zbritëse dhe trashëgon atë pjesë të trashëgimisë që do ta kishte trashëguar paraardhësi i tij sikur të kishte qenë gjallë.

Me të drejtën e shtimit zbatohet kur pjesa e një apo më shumë trashëgimtarëve mbetet e lirë, kur e drejta e përfaqësimit nuk mund të zbatohet. P. Sh. Nëse trashëgimlënësi ka vdekur dhe pas vetës ka lënë dy fëmijë. Nëse njëri prej fëmijëve ka vdekur para trashëgimlënësit dhe pas vetës nuk ka lënë pasardhës, atëherë pjesën që do ta trashëgonte ky do ta trashëgojë fëmija tjetër. Ose , gjithë pasurinë.

Në radhën e dytë të trashëgimisë ligjore trashëgojnë, dy prindërit, bashkë  $\frac{1}{2}$ , kurse secili veç e veç nga  $\frac{1}{4}$ , dhe bashkëshorti vetëm  $\frac{1}{2}$ . Edhe këtu zbatohet e drejta e shtimit dhe e përfaqësimit.

Në radhën e tretë të trashëgimisë na formohen dy trungje; TRUNGU I ATËSISË DHE TRUNGU I AMËSISË. Secili trung trashëgon nga  $\frac{1}{2}$ . Ndërsa secili gjysh apo secila gjyshe trashëgon nga  $\frac{1}{4}$ . Edhe këtu zbatohet e drejta e shtimit dhe e drejta e përfaqësimit.

Në radhën e tretë trashëgojnë vetëm trashëgimtarët e thirrur në trashëgimi sipas faktit të gjinisë së gjakut.

Komuna si trashëgimtar ligjor trashëgon kur trashëgimlënësi ka vdekur, nuk ka lënë trashëgimtar as me testament as ligjor. Atëherë, pasurinë trashëgimore e trashëgon komuna ku trashëgimlënësi e kishte vendbanimin e fundit ose vendqëndrimin e fundit.

**Republika e Kosovës trashëgon kur nuk dihet as vendbanimi as vendqëndrimi i trashëgimlënësit.**